

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Kompania e Sigurimeve INSIG sh.a kërkon të punësojnë në Departamentin e Dëmeve

Pozicioni i punës:

Specialist i pritjes së kërkesave për dëmshpërblim.

Kualifikimet dhe Aftësitë e Kërkuara:

Edukimi: Diplomë Universitare, e preferueshme diploma për “Inxhinieri Mekanike”.

Eksperiencë pune: Preferohen eksperiencat e ngjashme të punës.

Aftësitë:

- Të jetë i gatshëm dhe i aftë të punojë në grup;
- Të pëlqejë punën me njerëzit dhe të jetë entuziast;
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese dhe etike në komunikim;
- Të komunikojë rrjedhshëm anglisht;
- Të ketë paraqitje të denjë.
- Njohuri të mira të programeve të paketës Microsoft Office

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Mirëpret me etikë të lartë profesionale çdo individ që paraqet kërkesë për dëmshpërblim apo kërkesa të tjera që lidhen me trajtimin e praktikave të dëmeve;
- Dëgjon me vëmendje paraqitësin e kërkesës dhe e informon mbi dokumentacionin që duhet depozituar;
- Ofron informacion duke i ardhur në ndihmë kërkuarit për afatet e trajtimit të kërkesës (*ekspertize, vlerësim dhe pagesë*);
- Vendos në dispozicion të kërkuarit formularët përkatës dhe sigurohet për plotësimin korrekt të tyre;
- U përgjigjet të gjitha thirrjeve telefonike në mënyrë profesionale në përputhje me standardet dhe siguron që të gjitha kërkesat të adresohen tek personat përgjegjës;
- Bën njoftimet e vlerave të dëmshpërblimeve dhe i printon ato;
- Bashkëpunon ngushtë me koleget e Departamentit, Degët në rrethe dhe Departamentet e tjera, në funksion të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim;

- Trajton kërkesat e klientëve në mënyrë profesionale dhe efikase;
- Kryen detyra të tjera që i kërkohen nga eprori.

Për te aplikuar në këtë pozicion pune , dërgoni CV-në tuaj me email në adresën mhasanaj@insig.com.al

Afati aplikimit është deri më datë 16 Qershor 2024